



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:247102

Datë: 05.10.2021

Numri i dokumentit: 02245045

C.nr.3104/15

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, duke shqyrtuar dhe zgjidhur kontestin nga marrëdhënia juridike civile të paditësve A. N. dhe L. K., që të dy nga fshati Llapushnik, Komuna e Gllogocit, që të dy përfaqësuar me autorizim nga Bajram Azemi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurave Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë, përfaqësuar në shqyrtimin kryesor nga Veton Bublaku, dhe Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, përfaqësuar në shqyrtimin kryesor nga Adnan Pacolli, avokat në Prishtinë, me objekt të kontestit shpërblimin e dëmit jo material dhe material, me vlerë të objektit të kontestit në shumë prej 15,493.00€ (pesëmbëdhjetë mijekatër qindënëntëdhjetë euro), pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur më 06.09.2021, në seancë publike, të mbajtur në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, të njëjtën datë, kurse më 15.09.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT aprovohet si e themeltë kërkesëpadia e paditësit A. N., fshati Llapushnik, Komuna e Gllogocit, ashtu që DETYROHEN të paditurat Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë për 70% (shtatëdhjetë përqind) të përgjegjësisë dhe Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë për 30% (tridhjetë përqind) të përgjegjësisë, paditësit në emër të shpërblimit të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 06.07.2015, t’ia paguajnë shumat në të holla si në vijim:

a) Në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 1,100.00€ (njëmijenjëqind euro), për dhimbje shpirtërore për shkak të frikës shumën prej 850.00€ (tetëqindesëdhjetë euro), dhe për shëmtim në shkallë të mesme shumën prej 1,875.00€ (njëmijetetëqindeshtatëdhjetepesë euro).

b) Në emër të dëmit material për shpenzimet e kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë shumën prej 140.00€ (njëqindedyzet euro), dhe për shpenzimet e ushqimit të përforcuar shumën prej 140.00€ (njëqindedyzet euro).

II. PJESËRISHT aprovohet si e themeltë kërkesëpadia e paditësit L. K., fshati Llapushnik, Komuna e Gllogocit, ashtu që DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë për 70% (shtatëdhjetë përqind) të përgjegjësisë, paditësit në emër të shpërblimit të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 06.07.2015, t’ia paguajnë shumat në të holla si në vijim:

a) Në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 650.00€ (gjashtëqindesëdhjetë euro), dhe për dhimbje shpirtërore për shkak të frikës shumën prej 500.00€ (pesëqind euro).

b) Në emër të dëmit material për shpenzimet e kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë shumën prej 84.00€ (tetëdhjetekatër euro), dhe për shpenzimet e ushqimit të përforcuar shumën prej 84.00€ (tetëdhjetekatër euro).

III. REFUZOHET si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit A. N., fshati Llapushnik, Komuna e Gllogocit, përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit rrugor të datës 06.07.2015, për shumat e specifikuar si më poshtë:

a) Në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 1,800.00€ (njëmijetetëqind euro), për dhimbje shpirtërore për shkak të frikës shumën prej 935.00€ (nëntëqindetridhjetepesë euro), dhe për shëmtim në shkallë të mesme shumën prej 3625.00€ (tremijegjashtëqindenjëzetepesë euro).

b) Në emër të dëmit material për shpenzimet e kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë shumen prej 300.00€ (treqind euro), për shpenzimet e ushqimit të përforcuar shumën prej 300.00€ (treqind euro), dhe për shpenzimet e rehabilitimit fizioterapiotik shumën prej 220.00€ (dyqindnjëzet euro).

IV. REFUZOHET si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit L. K., fshati Llapushnik, Komuna e Glllogocit, përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit rrugor të datës 06.07.2015, për shumat e specifikuar si më poshtë:

b) Në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 1,450.00€ (njëmijekatërqindpesëdhjetë euro), dhe për dhimbje shpirtërore për shkak të frikës shumën prej 970.00€ (nëntëqindeshtatëdhjetë euro).

b) Në emër të dëmit material për shpenzimet e kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë shumen prej 180.00€ (njëqindtetëdhjetë euro), për shpenzimet e ushqimit të përforcuar shumën prej 180.00€ (njëqindtetëdhjetë euro), dhe për shpenzimet e rehabilitimit fizioterapiotik shumën prej 110.00€ (njëqinddhjetë euro).

V. DETYROHEN të paditurat, që shumat e gjykuara si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'i paguaj me kamat vjetore prej 8% (tetë përqind), dhe atë për nën-pikat a) duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (06.09.2021), e deri në pagesën e plotë, kurse për nën-pikat b) duke filluar nga data e parashtrimit të padisë më datë 16.12.2015 e deri në pagesën e plotë, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

VI. DETYROHET të paditurat, që paditësve t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,533.20€ (njëmijepesëqindetridhjetetë euro), dhe atë e paditura e parë Kompania e Sigurimeve "Elsig", shumën prej 1,073.24€ (njëmijeshtatëdhjetetë euro e njëzetekatër euro/cent) për 70% (shtatëdhjetë përqind) të përgjegjësisë, ndërsa e paditura e dytë Kompania e Sigurimeve "Siguria", shumën prej 459.96€ (katërqindpesëdhjetenëntë euro e nëntëdhjetegjashtë euro/cent) për 30%

(tridhjetë përqind) të përgjegjësishë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit në këtë gjykatë më 16.12.2016, përmes të autorizuarës të tyre kanë parashtruar padi, fillimisht kundër të paditurës së parë dhe pas marrjes së ekspertizës kanë bërë zgjerimin e padisë dhe kundër të paditurës së dytë për shpërblimin e dëmit material dhe jo material të precizuar së fundi me parashtrësën e dorëzuar në seancën e datës 06.09.2021, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të shpërblimit të dëmit material dhe jo material për aksidentin rrugor të ndodhur më 06.07.2015, t'ia paguaj shumat si në vijim: për paditësin A. N. në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 2,900.00€, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1,785.00€, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 5,500.00€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 440.00€, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 440.00€, në emër të rehabilitimit shumën prej 220.00€, dhe për paditësin L. K. në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 2,100.00€, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1,470.00€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 264.00€, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 264.00€, në emër të rehabilitimit shumën prej 110.00€, e të gjitha shumat me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim, e deri në pagesën përfundimtare.

Në padi kanë theksuar se më 06.07.2015, në rrugën Pejë – Prishtinë është shkaktuar aksidenti i trafikut në të cilin aksident paditësit kanë pësuar lëndime trupore. Deri te aksidenti i trafikut ka ardhur derisa paditësit në atë kohë ishin duke udhëtuar me automjetin e tipit “Caddy” me targa 01-...-... ku papritur automjeti i tipit “Mercedes 201”, me targa ...-KS-....., të cilin e ngiste A. V. i cili në mënyrë të pasigurte bënë ndërrim shiriti me që rast e godet automjetin e paditësve duke shkaktuar aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime trupore. Ka shtuar se paditësit menjëherë pas aksidentit janë dërguar në QKUK në Prishtinë ku është konstatuar se kanë pësuar lëndime trupore.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 312.00€, për përfaqësim në 2 seanca nga 405.60€ për seancë, në shumë prej 810.20€, për

ekspertiza mjekësore shumë prej 200.00€, për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 150.00€, për taksën gjyqësore për padi shumë prej 60.00€, në shumë të përgjithshme prej 1,533.20€.

E paditura e parë përmes të autorizuarit të saj, përmes përgjigjes në padi, seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve duke dhënë edhe ofertë për lidhjen e një pajtimi gjyqësor, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve mbi shumë e ofruar ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzime nuk është deklaruar.

E paditura e dytë, përmes të autorizuarit të saj, nuk e ka kundërshtuar zgjerimin e padisë, duke pranuar përgjegjësin për 30% për paditësin A. N. dhe duke dhënë një ofertë. Ka shtuar se lartësia e kërkesëpadisë së precizuar është tejet e lartë dhe nuk është në harmoni me praktikën gjyqësore, andaj mbi shumë e ofruar i ka propozuar gjykatës që të refuzon kërkesën e paditësit si të pabazuar.

Lidhur me shpenzime nuk është deklaruar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat e propozuara nga palët ndërgjyqëse si në vijim: dokumentacionin mjekësor për paditësit, raportin policor nr. 2015-AR-1543, të datës 06.07.2015, ekspertizën e komunikacionit të datës 08.04.2021 dhe ekspertizën mjekësore të datës 24.06.2021.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe si e tillë është aprovuar.

Me provat e administruara gjykata ka gjetur se me 06.07.2015, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ashtu që derisa i siguruari i të paditurës së parë ishte duke lëvizur nga drejtimi i Pejës në drejtim të Prishtinës, në shiritin e djathtë të rrugës bën

ndërrimin e shiritit para semaforit në të majtë duke dashur të bëj gjysmë-kthim majtas ku është e ndaluar me shenjë trafiku, ia ka ndërprerë rrugën paditësit L. K. dhe nga pamundësia që të ndalet e godet me pjesën e përparme në krahun e majtë në me të automjetit.

Deri të kjo gjendje faktike gjykata ka ardhur duke u mbështetur në këto prova të cilat i ka pranuar si të besueshme dhe atë: raporti i aksidentit nr. 2015-AR1543,06.07.2015, dhe ekspertiza e komunikacionit e datës 08.04.2021, të punuar nga eksperti S. B.

Sipas ekspertizës së komunikacionit e punuar nga eksperti S. B., e datës 08.04.2021, rezulton së shkaktar kryesor dhe i drejtpërdrejt i aksidenti është A. V., i siguruari i të paditurës së parë, i cili ka bërë kthim i pasigurte në udhëkryq nga shiriti i djathtë në të majtë dhe ndalim kthim gjysmë rrethor sipas shenjës së komunikacionit, dhe kontribut sekondar ka paditësi L. K., i cili ka drejtuar automjetin me shpejtësi jo adekuate sipas shenjave të komunikacionit.

Gjykata ekspertizën e komunikacionit e ka vlerësuar si profesionale dhe argumentuar mirë prandaj të njëjtë e ka pranuar në tërësi si të besueshme pasi që edhe vet palët ndërgjyqësore nuk e kanë kontestuar.

Mbi bazën e të lartcekurave gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë sipas kontributit të pjesëmarrësve në aksident dhe ka vendosur që përgjegjësia të jetë 70% për të paditurën e parë dhe 30% për të paditurën e dytë në raport me paditësin A. N..

Sa i përket përgjegjesisë së ndarë gjykata ka aplikuar dispozitat e nenit 176 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve - (LMD).

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për ta kompensuar paditësin gjen mbështetje në dispozitat nga neni 136, 137 dhe 140 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditëses, në cilësinë e provës materiale, ka nxjerr ekspertizën mjekësore të punuar nga Dr. M. H., ekspert i ortopedisë dhe Dr. S. B., ekspert i psikiatrisë, të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësve, kanë dhënë mendimin profesional, përmes ekspertizës së punuar me shkrim datë 24.06.2021.

Sipas kësaj ekspertize paditësi A. N., sipas ekspertizës mjekësore i njëjti në aksidentin e komunikacionit ka pësuar lëndime dhe atë ndrydhje koke, ndrydhje qafe, ndrydhje në gjurin e djathtë, plagë prerëse - shkyese në ballë në anën e djathtë, plagë dhe gërvishtje në fytyrë në anën e djathtë, hundë, vetulla dhe mollëza, dhe si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike aprovoi kërkesën në shumën prej 1,100.00€, dhe e vlerësoi si një shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi A. N., sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped si pasojë e lëndimeve të marra, ka pësuar dhembje fizike të intensitetit të rëndë 2 ditë- kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate duke marrë parasysh lëndimet e qafës e sidomos të plagëve të shumta në fytyrë e të cilat nuk mund të imobilizohen dhe jep dhimbje në çdo lëvizje, dhembje fizike të intensitetit të mesëm 20 ditë – kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, të cilat ndërliken me kohën e nevojshme për konsolidimin e lëndimeve trupore dhe dhimbje të intensitetit të ultë sot e kësaj dite, posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike.

Ne emër të frikës së pësuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 850.00€, dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë, paditësi A. N. ka pësuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekondash dhe që është përcjellë me frikë nga vdekja dhe kërcënimit direkt për integritetin e tij trupor. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar përreth 24 orë, që është manifestuar me simptome të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, frikë nga procedurat mjekësore, çrregullim gjumi, rikujtime të ngjarjes, çrregullim disponimi dhe ankesa të shumta simatike. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe të ultë ka përjetuar për 2 deri 4 muaj dhe është ende e pranishme, e manifestuar me reagime emocionale të karakterit ansioz, lodhje në angazhimet minimale, zgjime të herë pas

hershme gjatë gjumit me rikujtime të ngjarjes traumatike. Po ashtu ka probleme sidomos me koncentrimi dhe vëmendje si dhe kokë dhimbje të shprehura, frikë; dhe pasiguri ka edhe sot e kësaj dite në pjesëmarrje në komunikacion, por të intensitetit të ulur.

Në emër të shëmtimit të pësuar për paditësin A. N. gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,875.00€, dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se nga ekspertiza të ky paditës është prezent shëmtimi trupor në shkallë të mesme për shkak të vrragëve të shumta si pasojë e plagëve prerëse – shkyese në pjesën e ballit në anën e djathtë, në vetullën e djathtë, në hundë në pjesën e përparme dhe anësore të majtë, në mollëz dhe pjesën e gjurit dhe shputës.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 140.00€ si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 20 ditëve.

Kurse në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 140.00 €uro si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për t'i kryer shumicën e aktiviteteve të përditshme jetësore në kohëzgjatje prej 20 ditësh.

Shumat e kompensimit në emër të këtyre dy kategorive të dëmit, gjykata i ka caktuar në mungesë të provave materiale, pasi nuk ekzistojnë prova për vërtetimin e këtyre bazave. Lartësinë e dëmit material të pësuar nga paditësi për këto dy baza gjykata e ka vlerësuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore andaj me çmuarje të lirë dhe konform nenit 323 të LPK-së ka arritur në përfundim se shumat e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave. Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara për faktin se shumat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe nuk janë në harmoni me praktikën gjyqësore.

Ndërsa sa i përket paditësi L. K., sipas ekspertizës mjekësore i njëjti në aksidentin e komunikacionit ka pësuar lëndime dhe atë ndrydhje qafe, ndrydhje gjoksi dhe ndrydhje në shpinë, dhe të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike aprovoi kërkesën në shumën prej 650.00€, për paditësin L. K. dhe e vlerësoi si një shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped si pasojë e lëndimeve të marra, ka pësuar dhembje fizike të intensitetit të rëndë 1 ditë – kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate duke marr parasysh lëndimet e qafës e sidomos të gjoksit e të cilat nuk mund të imobilizohen dhe jep dhimbje në çdo lëvizje, dhembje fizike të intensitetit të mesëm 12 ditë – kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate të cilat ndërlidhen me kohën e nevojshme për konsolidimin e lëndimeve trupore dhe dhimbje të intensitetit të ultë sot e kësaj dite, posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike.

Ne emër të frikës së pësuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 500.00€, dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë, paditësi L. K. ka përjetuar frikë primare në momentin e aksidentit që ka zgjatur disa sekonda dhe që është përcjellë me frikë nga vdekja dhe kërcënimit direkt për integritetin e tij trupor. Frikë sekondare të intensitetit të lartë që është manifestuar me simptome të ankthit të gjeneralizuar, shqetësime, frikë nga procedurat mjekësore, çrregullime gjumi, rikujtime të ngjarjes, çrregullim disponimi dhe ankesa të shumta somatike e që ka zgjatur për 24 orë. Frikë sekondare me intensitet mesatar dhe më të ultë e cila ka zgjatur për 2 deri 4 muaj dhe është edhe e pranishme e manifestuar me reagime emocionale të karakterit ansioz, lodhje në angazhimet minimale, zgjime të herë pas herëshme gjatë gjumit me rikujtime të ngjarjes traumatike.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 84.00€ si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 12 ditëve.

Kurse në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 84.00 Euro si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për t'i kryer shumicën e aktiviteteve të përditshme jetësore në kohëzgjatje prej 12 ditësh.

Shumat e kompensimit në emër të këtyre dy kategorive të dëmit, gjykata i ka caktuar në mungesë të provave materiale, pasi nuk ekzistojnë prova për vërtetimin e këtyre bazave. Lartësinë e dëmit material të pësuar nga paditësi për këto dy baza gjykata e ka vlerësuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore andaj me çmuarje të lirë dhe konform nenit 323 të LPK-së ka ardhur në përfundim se shumat e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave. Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara për faktin se shumat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe nuk janë në harmoni me praktikën gjyqësore.

Ekspertizën e lartpërmendur gjykata e mori në tërësi të bazuar dhe ia dha besimin e plotë, këtë nga se ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoi se e paditura mbanë përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësve me rastin e lëndimit gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditësve t'ua kompensoi dëmin me që shkaktuesi i dëmit, përkatësisht mjeti motorik nuk ka qenë i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bën e paditura mbi bazën neni 18 par. 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia konform nenit 159 par.1 dhe 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësve, moshën e tyre, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lartë,

gjkata miratoj kërkesëpadinë e paditësve e në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke vlerësuar si shpërblim real, objektiv dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit.

Gjykata konsideron se shumat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfacion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar të paditësve në aksidentin e komunikacionit, lëndimit dhe pasojave duke marre parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve, standardin jetësor të qytetareve të Kosovës dhe praktiken e deritanishme të Gjykatave të Kosovës.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin jo material dhe material gjykata vendosi si në pikat III dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit pasi që vlerësoi se kompensim përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Gjykata ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësve me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurat që në emër të rehabilitimit fizioterapeutik t'ia paguaj shumën prej 220.00 euro për paditësin A. N., dhe shumën prej 110.00€, ngase paditësit për këtë kërkesë gjykatës nuk i kanë ofruar ndonjë provë që do të argumentonte dhe provonte këtë bazë të dëmit për të cilën kërkon kompensim. Andaj në mungesë të dëshmvive për dëmin material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit për pjesën e refuzuar.

Gjykata lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e llogaritur dhe atë për dëmin jo material duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (06.09.2021), e deri në pagesën e plotë, kurse për dëmin material duke filluar nga data e parashtrimit të padisë më datë 16.12.2016 e deri në pagesën e plotë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerr konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së si dhe sipas tarifës zyrtare të Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë: për

parashtrimin e padisë shumë prej 312.00 euro, për 2 përfaqësime në seancë shumë prej 811.20 euro, për ekspertiza shumë prej 350.00 dhe për taksë gjyqësore shumë prej 60.00, respektivisht shumë e tërësishme të shpenzimeve prej 1,533.20 euro, pasi që këto janë shpenzime proporcionale me suksesin e arritur në procesin gjyqësor dhe kanë qenë shpenzime të domosdoshme.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.3104/15, më 06.09.2021

Përparim Zeka

Gjyqtar

UDHËZIMI PËR TË DREJTËN E ANKIMIMIT:

Kundër këtij aktgjykimi të dhënë palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së këtij aktgjykimi, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë. Ankesa i paraqitet i kësaj gjykate në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare.